



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4597 Prot.

Fushë-Arrëz, më 13 . 12 .2024

NJOFTIM

PËR MBLEDHJE TË KËSHILLIT TË BASHKISË DHE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak:

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, si dhe Rregullores për funksionimin e Këshillit të Bashkisë, në bazë të mbledhjes së Kryesisë së Këshillit të datës 09. 12. 2024, njoftoheni se mbledhja radhës e Këshillit të Bashkisë për muajin Dhjetor 2024 zhvillohet, **ditën e hënë, datë 23. 12. 2024, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak** me rend dite:

1. Miratimi i Projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Nëntor 2024.
2. Miratimi i Projektvendimit për strukturën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Administratës së Bashkisë, Njësive Administrative, Institucionet e varësisë dhe Funksionet specifike për vitin 2025.
3. Miratimi i Projektvendimit për Paketën Fiskale 2025.
4. Miratimi i Projektvendimit për Prioritetet në Shërbime dhe Investime për vitin 2025 e në vazhdim.
5. Miratimi Projektvendimit për planin e aktiviteteve, planin e konsultimeve dhe buxhetin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2025.
6. Miratimi i Projektvendimit për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të bashkisë Fushë-Arrëz.
7. Miratimi i Projektvendimit për miratimin e bursave të nxënësve të Arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2024-2025.
8. Miratimi i Projektvendimit për Planin e Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore Iballe-Mezi, në territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.

9. Miratimi i Projektvendimit për Planin e Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027.

10. Rishqyrtimi i vendimeve të kthyer nga Prefektura.

11. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.

12. Të ndryshme.

MBLEDHJE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME :

- a) Mbledhja e Komisionit të Mirëqenjes Sociale, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut (**Franc Doda ,Tereze Dema, Pavlin Qafa**), ditën e **enjte**, datë **19. 12. 2024**, ora **11:00** në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **1** të rendit të ditës.
- b) Mbledhja e Komisionit të Ekonomisë, Financave, Buxhetit, Mbikqyrjes Financiare, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, (**Franc Doda, Valentin Doçi, Valentina Lleshaj, Besjana Marku, Zef Cara**), ditën e **premtë**, datë **20. 12. 2024**, ora **14:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **2**, pikën **3**, pikën **5** dhe pikën **6** të rendit të ditës.
- c) Mbledhja e Komisionit të Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit, Shërbimeve Publike, Transportit, dhe Strehimit (**Afrim Ndoj, Mustaf Pashkaj, Besjana Marku**), ditën e **premtë**, datë **20. 12. 2024**, ora **9:30**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **4** të rendit të ditës.
- d) Mbledhja e Komisionit të Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Rinisë, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve (**Besjana Marku, Tereze Dema, Franc Doda**), ditën e **enjte**, datë **19. 12. 2024**, ora **12:00** në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **7** të rendit të ditës.
- e) Mbledhja e Komisionit të Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, Turizmit, Mbrojtjes së Mjedisit (**Mustaf Pashkaj, Nikolin Sadikaj, Pavlin Qafa**) ditën e **premtë**, datë **20. 12. 2024**, ora **10:30**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **8** të rendit të ditës.
- f) Mbledhja e Komisionit Juridik të Mandateve, Rregullores, Qeverisjes së Mirë, Zgjedhjeve, Administratës dhe Strukturave Komunitare (**Lin Preni, Afrim Ndoj, Vjollca Tabakaj**) ditën e **enjte**, datë **19. 12. 2024**, ora **10:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **9** të rendit të ditës.

Duke kërkuar korrektësinë tuaj për pjesëmarrjen në mbledhjet e komisioneve dhe mbledhjen plenare të Këshillit të Bashkisë!

KRYETARI
Nikolin BARDHOKU

